



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 17158/ Prot.

Lezhë, më 13. 11. 2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në datën 13.11.2024, në orën 11:00, në sallën e Bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë, mbi dëgjesën publike në lidhje me miratimin e listës së pjesshme paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë, për pasuritë me nr. 24/10, nr. 49/12 në ZK 1987, Nj.A. Shëngjin, në koordinim me administratën e Bashkisë Lezhë.

Takimi u hap nga zv/Kryetari i Bashkisë Lezhë z. Fatjon Zefi, i cili shpjegoi qëllimin e miratimit të kësaj liste.

-Fatjon Zefi: Regjistrimi i pronave publike që janë shtet dhe duhet të regjistrohen në emër të Bashkisë është çështja më serioze për momentinsepse pa pasë dokument pronësie, e dimë shumë mirë që nuk mund të ketë zhvillim ekonomik, pengohen projekte strategjike.

Sot kemi për diskutim një pronë që ndodhet në Ishull Shëngjin, pa shkuar te Knalla, janë pothuaj 25 ha, pak a shumë është te impianti i trajtimit të ujrave të zeza. Parcelat kadastrale janë ato të dyja në shfaqen dhe në monitor. Qëllimi është regjistrimi i këtyre pronave në emër të bashkisë për projekte strategjike që mund të ofrohen në të ardhmen.

Nëse konsultimi publik shkon mirë, do të shkojë si propozim për vendim këshilli, e me radhë për VKM, gjithmonë nëse do marrë pëlqimin e ministrive përkatëse, por pika e parë është konsultimi publik dhe i atyre që janë të zonës.

-Në vijim zv/kryetari i Bashkisë Lezhë u dha fjalën të pranishmëve për diskutime lidhur me propozimin.

-Esat Dushku, qytetar: Kisha një pyetje. Cili është statusi aktual i kësaj prone dhe çfarë procedurash të tjera ka?

-Fatjon Zefi: Është shtet. Do e kalojmë në emër të Bashkisë Lezhë. Normalisht çdo pronë e ka një ministri përkatëse. Kënetën e ka një ministri, pyllin e ka një ministri tjetër, tokën arë e ka Ministria e Bujqësisë, prandaj ne do të paraqitemi në institucione më të larta, në qoftë se biem dakord në parim, gjithmonë duke pasë parasysh që i shërben komunitetit. Projektet strategjike janë në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik të zonës.

Ne vazhdimisht do u kërkojmë miratim atyre, nuk ka as vendim kthimi pronash, as AMTP, sepse është kënetë dhe kënetë nuk ka qenë subjekt i ndarjes së tokës.

-Nik Uka, qytetar: Fiks ku është kjo si parcelë?

-Fatjon Zefi: Te knalla, në krahun e poshtëm të rrugës, është një bllok banesash dhe përfundon te rruga e re që është bërë Kune-Peshkatari.

-Qytetar i pranishëm: Përderisa është tokë shtet përse diskutohet për t'u kthyer në dispozicion të bashkisë dhe arsyeja dhe a është parë nga institucioni se për çfarë mund të përdoret dhe a ka ndonjë projekt të bërë dhe a kontrollohen këto projekte nëse kanë ndonjë problem për kumunitetit i cili jeton në Shëngjin dhe nga kush kontrollohen.

-Fatjon Zefi: Mund të përdoret për investime të ndryshme në të ardhmen. Një investim është në këtë pronë që është impianti i ujrave të zeza. Nqs nuk ka çertifikatë pronësie nuk mund të thithet asnjë investim aty. Ti as shtëpi nuk mund të ndërtohet, nqs tokën e ke pa letra.

Për të shkuar në një realizim projekti ka disa procedura, ashtu si edhe kjo sot, është një procedurë. Nqs do investohet projekt do merret mendimi i të gjitha drejtorive përkatëse, ministrive përkatëse, bashkisë. Nuk realizohet një projekt pa funksionuar çdo pikë sipas ligjit, nuk ka ndodhur kurrë. Ky është hapi i parë, regjistrimi në emër të bashkisë. Pastaj kur të vijë një investim, do bëhet konsultim publik për atë investim. Nuk do të thotë që sot po biem dakord për t'u bërë një investim. Ky është konsultim publik, siç është bërë dhe njoftimi, vetëm për regjistrim prone pranë bashkisë.

-Zek Doda, anëtar KB Lezhë: Kjo është një procedurë që ia marrim shetit dhe ia kalojmë bashkisë. Jemi dakord.

-Fatjon Zefi: Është procedura e tillë. Është një tokë që nuk përdoret për asgjë dhe i kalon bashkisë. Kjo nuk është gjë e keqe besoj.

-Pjeter Tushaj, anëtar KB Lezhë: (i referohet hartës) A mund të na sqarojnë specialistët nëse mund të ketë konflikt pronësie.

-Fatjon Zefi: Konflikt pronësie nuk ka sepse kjo është komplet kënetë. Anash saj që është me dokumet pronësie është arë. Këto dy parcela janë kënetë. E kemi marrë informacionin zyrtar nga hipoteka dhe është shtet, nuk ka asnjë lloj pretendimi nga privatë.

-Lirim Torba, anëtar KB Lezhë: Është një lokacion i hedhur këtu me emrin Nazmi Kica. Duhet parë se mos ka ndonjë certifikatë pronësie.

-Fatjon Zefi: E kam parë, është ujë.

-Erin Ndreca, anëtar i Kryesisë së KB Lezhë: Përshëndetje. Që të sqarojmë diçka, që ta thjeshtojmë. Bashkia ka të drejtë si institucion që të kërkojë që të ketë në pronësinë e saj territore të caktuara, ku bashkia krijon planet e saj strategjike për zhvillim dhe në këtë rast bashkia ka të gjithë të drejtën ligjore që të bëjë kërkesë për ta kaluar këtë pronë shtetërore si pronë të saj. Konsultimet publike bëhen që banorët të shprehin mendimet e tyre por nuk është detyra e asnjërit nga ne që të themi është apo nuk është e lirë sepse janë organet dhe institucionet shtetërore përkatëse që i kontrollojnë dhe mbajnë përgjegjësi nëse janë prona të zëna a të pazëna. Nuk kemi pse shqetësohemi ne në lidhje me këtë aspekt sepse nuk është përgjegjësia jonë, sepse patjetër që

bashkia rakordon me Kadastrën, me ministritë përkatëse, pra ka instanca të tjera që i vërtetojnë këto gjëra. Ideja është që ne t'i japim mundësi bashkisë që për të rritur zhvillimin ekonomik të zonës dhe në lidhje me këtë kush ka një mendim, ta thotë por jo të kalojmë në gjëra të tjera.

Patjetër që çdo investim strategjik ka konsultim publik, siç e theksoi zv/kryetari.

Ne i japim përparësi çdo investimi strategjik që i paraqitet bashkisë. I paraqitet tani apo më vonë ndoshta.

-Fatjon Zefi: Gjithashtu kush ka pretendime në zonë, mund t'i drejtohet njësisë administrative, por duke qenë kënetë, çdo AMTP është nul, nuk është tokë që është trajtuar me ligjin 7501.

-Sandër Marku, qytetar: Falenderoj miqtë e mi që më kanë ftuar si dhe ju si institucion për dëgjuesën publike. Mora shkas dhe nga parafolësi. Desha të ndaj mendimin tim sa jam i njohur me legjislacionin. Nëse toka është shtet, po kalon nga shteti në shtet te bashkia. Bashkia është pronare e krejt zonës së saj, bazuar, siç tha dhe kolegu që keni në krah. Ndërsa ndërhyrjet për të marrë dokumentacionin te organet më lart, siç janë ministritë përkatëse, është ok. Duke qenë se qenka shtet, ai uji që qenka aty dhe më përtej ka prona, uji është hedh si me qenë pishinë? E dyta, unë do kisha një sugjerim, të ftohen banorët e Nj.A. Shëngjin sepse mund të ketë banorë që mund të mos jenë pajisë me tokë akoma. Pra t'u ofrohet banorëve para se strategjikut. Unë mendoj që kjo dëgjuesë është shumë e mirë dhe të bëhet me banorët e Nj.A. Shëngjin. Ata njohin problematikat, njohin situatën, dinë edhe kufijtë dhe pastaj të kalohet në faza të tjera. Ju falenderoj për modelin e dëgjësave.

-Fatjon Zefi: Një sqarim të shkurtër për pikën e fundit, nuk mund të trajtohen banorët sepse bie ndesh me ligjin sepse ajo është ujë, është kënetë. Edhe nqs ka njërëz që nuk janë trajtuar dhe duhen trajtuar, nuk mund t'i trajtosh aty. Ndërsa te pika tjetër, është shtet por është në varësi të ministrisë përkatëse dhe ne i marrim pëlqim asaj për të kaluar në emrin tonë. Kur themi investime strategjike, do të thotë ato që marrin pëlqimin nga bashkia nesër pasnesër. Njoftimi për konsultimin publik ka qenë për të gjithë, për banorët e nj. A. Shëngjin kryesisht. Njoftimi është bërë publik.

Ka diçka tjetër?

Atëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mendimet.

KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

SEKRETARI

Floride Çunaj
4

BASHKIA LEZHË

Drejtoria e Administrimit

të Aseteve dhe Kadastrës

DREJTORI

BARDHOK BARDHI
Bardhok Bardhi